



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

Tiranë më, 3.09.2019

Dokument parlamentar

### RAPORT

#### PËR PROJEKTLIGJIN

#### “PËR

#### **RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT, PËR TRANSPORTIN DETAR”**

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit, për transportin detar”, në mbledhjen e datës 3 shtator 2019.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Besnik Baraj relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin z. Artan Shkreli, zëvendësministër i ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Ky projektligj synon ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit, në fushën e transportit detar, në bazë të parimeve të lundrimit të lirë, duke marrë parasysh parimet e barazisë, të bashkëpunimit dhe të përfitimeve të ndërsjella, me qëllim forcimin e marrëdhënieve ndërmjet të dyja vendeve.

Marrëveshja është miratuar, në parim, me vendimin nr. 316, datë 15.4.2015, të Këshillit të Ministrave dhe bazohet në konventën e Kombeve të Bashkuara për ligjin e detit si dhe në konventa të tjera ndërkombëtare, për sigurinë e transportit detar, lehtësimin e transportit detar ndërkombëtar, kushtet e jetës dhe të punës së detarëve, transportin e mallrave të rrezikshme dhe mbrojtjen e mjedisit detar.

Në 16 nenet e saj marrëveshja: bën përkufizimin e termave sipas konventave ndërkombëtare në fushën e detarisë; përcakton parimet bazë, sipas konventave ndërkombëtare, mbi të cilat zhvillohet bashkëpunimi detar ndërmjet dy vendeve; detajon masat që duhet të ndërmarrin shtetet palë për lehtësimin e transportit detar ndërmjet të dyja vendeve; përcakton të drejtën për të vendosur përfaqësim në territorin e shteteve respektive; detyron dhënien e ndihmës së ndërsjellë anijeve të të dy shteteve në rast të incidenteve në det; u jep të drejtën palëve të lidhin marrëveshje financiare për të rregulluar çështjet që lidhen me të ardhurat dhe taksat, me qëllim shmangien e taksimit të dyfishtë.

Institucioni përgjegjës për zbatimin e këtij projektligji është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Projektligji nuk sjell efekte shtesë në buxhetin e shtetit.

**Në përfundim të diskutimeve**, Komisioni, me unanimitet, e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

**RELATOR**

**Besnik Baraj**

**KRYETAR**

**Niko PELESHI**